

KODI I ETIKËS SË MËSUESIT



“Etika ka të bëjë me vendimmarrjet e duhura në raport me një situatë të dhënë, kur edhe zgjidhjet ligjore janë të vështira”

PARIMET BAZË MBI TË CILAT BAZOHET KODI I ETIKËS SË MËSUESIT:

- 1 Përkushtimit ndaj nxënësit, mbi bazën e të cilit përcaktohen sjelljet që priten nga mësuesi në lidhje me procesin e të nxënit.
- 2 Përkushtimit ndaj profesionit, mbi bazën e të cilit përcaktohen sjelljet që priten nga mësuesi për përsosjen e cilësive të tij personale në funksion të të nxënit dhe të mjedisit arsimor që e mbështet atë në të gjitha drejtimet.
- 3 Përkushtimit ndaj komunitetit për krijimin e një mjedisi më motivues për arsimin.

PËRKUSHTIMI I MËSUESIT NDAJ NXËNËSVE, BAZUAR NË KODIN E ETIKËS

- ▶ Mësuesi beson në suksesin e çdo nxënësi dhe siguron kushtet e të nxënit për të gjithë.
- ▶ Mësuesi nxit dhe motivon të gjithë nxënësit për zhvillimin e plotë të potencialit të tyre intelektual, fizik, emocional, shoqëror e qytetar.
- ▶ Mësuesi njeh, kupton parimet e vlerësimit dhe i zbaton ato saktësisht, në mënyrë të ndershme, të paanshme e jo diskriminuese në praktikën e tij profesionale.
- ▶ Mësuesi vlerëson nxënësit në bazë të kritereve të pranuar të vlerësimit dhe regjistron e raporton rregullisht te të interesuarit (nxënësit, prindërit, shkollën etj.) për arritjet dhe progresin e tyre.
- ▶ Mësuesi përpiqet të ofrojë më të mirën e mundshme profesionale për nxënësit e tij dhe pranon kontributin e tyre në procesin e krijimit dhe të përvetësimit të njohurive.
- ▶ Mësuesi i ndihmon nxënësit të vlerësojnë identitetin e tyre, të mësojnë më shumë rreth trashëgimisë së tyre kulturore dhe të ushtrojnë përgjegjësitë e





tyre qytetare dhe shoqërore.

- ▶ Mësuesi trajton të gjithë nxënësit në mënyrë të barabartë dhe me respekt, në përputhje me ligjin, me dinjitetin dhe vlerat e tyre të brendshme.
- ▶ Mësuesi lufton sjelljet dhe praktikatat e pandershme, korruptive e të paligjshme që bien ndesh me këtë kod dhe angazhohet për standarde të larta etike në marrëdhënie me nxënësit.
- ▶ Mësuesi është model i sjelljes dhe i zgjidhjeve paqësore në marrëdhëniet me nxënësit dhe të gjithë të tjerët.
- ▶ Mësuesi njeh, kupton dhe zbaton parimet e përgjithshme të Konventës së të drejtave të fëmijës, në mënyrë të veçantë, parimin e interesit parësor të fëmijës dhe atë të trajtimit të barabartë të tij.
- ▶ Mësuesi njeh të gjitha format e mundshme të dhunës (fizike, psikologjike, etj.) ndaj nxënësve, brenda dhe jashtë mjedisit arsimor, dhe i shmang e i lufton ato së bashku me nxënësit.
- ▶ Mësuesi trajton me respekt dhe mirëbesim çdo informacion personal dhe të ndjeshëm për nxënësin dhe nuk e bën atë publik, nëse një gjë e tillë nuk i kërkohet nga ligji.
- ▶ Mësuesi është i vetëdijshëm për kufijtë e tij profesionalë në marrëdhënie me nxënësit dhe respekton ato në mjedisin arsimor.

SJELLJA ETIKE NDAJ NXËNËSVE



- ▶ Mësuesi profesionist pranon përgjegjësinë personale për të mësuar cilësitë e karakterit të nxënësve që do t'i ndihmojnë ata të vlerësojnë pasojat dhe të pranojnë përgjegjësinë për veprimet dhe zgjedhjet e tyre. Edhe pse ne afirmojmë prindërit si mësuesit parësorë moralë të fëmijëve të tyre, ne besojmë se të gjithë mësuesit janë të detyruar të ndihmojnë në nxitjen e virtyeteve qytetare si: integriteti, zelli, përgjegjësia, bashkëpunimi, besnikërinë, zbatimin e ligjit, kujdesi për jetën, për të tjerët dhe për veten.
- ▶ Mësuesi profesionist, duke pranuar pozicionin e tij ose të saj të besimit publik, mat suksesin jo vetëm me përparimin e secilit nxënës drejt realizimit të potencialit të tij personal por edhe si qytetar të komunitetit më të madh të republikës.
- ▶ Mësuesi profesionist merrret në mënyrë të konsiderueshme dhe të drejtë me secilin nxënës dhe kërkon të zgjidhë problemet, duke përfshirë disiplina, sipas ligjit dhe politikës së shkollës.
- ▶ Mësuesi profesionist nuk e ekspozon me qëllim nxënësin për keqpërdorim.
- ▶ Mësuesi profesionist nuk zbulon informata konfidenciale për nxënësit përveç nëse kërkohet me ligj.
- ▶ Mësuesi profesionist bën një përpjekje konstruktive për të mbrojtur nxënësin nga kushtet që dëmtojnë mësimin, shëndetin ose sigurinë.
- ▶ Mësuesi profesionist përpiqet të paraqesë faktet pa shtrembërim ose paragjykim personal.

